



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:224503

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05173865

AA.nr.991/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit – propozuesit, K... i M... “P...” të cilin e përfaqëson A...S... nga Prizreni, kundër të paditurës Bordi (Komisioni) Mbikëqyrës për Menaxhimin dhe Shfrytëzimin e Objekteve Publike dhe Sportive Kulturore dhe Rinore, me adresë në Prizren, me bazë juridike anulim i vendimit me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1830/2023 të datës 25.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit – propozuesit, K... i M... “P...”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1830/2023 i datës 25.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1830/2023 të datës 25.10.2023, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e paditësit – propozuesit, K... i M... “P...”, për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Bordit (Komisioni) Mbikëqyrës për Menaxhimin dhe Shfrytëzimin e Objekteve Publike dhe Sportive Kulturore dhe Rinore-Prizren, me nr.135847 të datës 19.09.2023, deri në vendosjen sipas padisë së paditësit, si e pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi-propozuesi, K... i M... “P...” të cilin e përfaqëson A... Sh... nga Prizreni, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës

materiale, ashtu siç rrjedhe nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit-propozuesit, ndërsa aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit nr.135847 ose çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit - propozuesit, kolegji i kësaj gjykate gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, me nr.135847 i datës 19.09.2023 ka gjetur se paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme pretendimin e tij, se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të cilin e kërkon, nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky ligjor për shtyrjen e ekzekutimit, e i cili duhet të provohet nga paditësi. Në dispozitivin e vendimit të atakuar përveç shfuqizimit të Vendimit të të paditurës, me nr.135847 të datës 19.09.2023, nuk përmban ndonjë urdhër për ndonjë veprim konkret të cilin duhet ta ndër marrë paditësi, andaj gjykata vlerëson se në mungesë të detyrimit për ndërmarrje të ndonjë veprimi aktiv nga ana e paditësit rrjedhimisht edhe nuk mund të shkaktohet asaj ndonjë dëm i pariparueshëm, e aq më pak të cenohet interesi publik. Paditësi-propozuesi në propozimin e tij ka theksuar se *me ekzekutimin e vendimit do të shkaktohet dëm i pariparueshëm sepse sportisti Olimpik E... S... do të mbetet pa hapësira në të cilat do të mund të ushtrohet dhe të përgatitet për gara sportive e në veçanti garat evropiane olimpike*, por sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë në rastin konkret nuk ekziston rreziku i shkaktimit të ndonjë dëmi të pariparueshëm apo i cenimit të interesit publik deri në përfundimin e procedurës gjyqësore, sepse pasoja e vetme e vendimit të të paditurës qëndron në faktin se pamundësimi i shfrytëzimit të sallës nga ana e një sportisti nuk përbën interes publik, por interes individual sepse i njëjti mund të shfrytëzoj edhe salla apo objekte të tjera me qëllim të përgatitjes së tij. Ndërsa në anën tjetër shtyrja e ekzekutimit të vendimit të të paditurës deri në vendosjen meritore nga ana e kësaj gjykate, sipas vlerësimit të gjykatës është në interes publik për shkak se parandalon mundësinë e shkëljes së ligjit dhe krijimit të pasojave ligjore në të ardhmen. Andaj, gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit - propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, i'u ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: *nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit - propozuesit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar*. Në rastin konkret paditësi - propozuesi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, deri sa gjykata të merr aktgjykim meritor lidhur me padinë e tij, me arsyetim se aktvendimi i gjykatës është marrë

në kundërshtim me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, sepse ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete se në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Në aktvendim gjykata nuk ka dhënë arsye bindëse si dhe nuk janë marre parasysh pretendimet e paditësit të paraqitura në padi, e njëjta nuk ka vlerësuar të gjitha provat dhe si rezultat i kësaj i është shkelur e drejta e paditësit. Paditësi nuk është shpallur fitues i shpalljes së ftesës për ofertën për dhënien në menaxhim dhe shfrytëzim deri në 1 vite të objekteve sportive përmes një vendimi të kundërligjshëm me shumë të meta juridike, duke nisur nga procedura e vlerësimit, dokumentet e vlerësuara e deri tek këshilla juridike e cila është shënuar gabimisht me të vetmin qëllim vënin në lajthim të palëve në procedurë. Po ashtu gjykata gabimisht ka vlerësuar se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative dy kushtet e përcaktuara me nenin 22par.2 të LKA-së.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të paditësit - propozuesit, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit të kësaj gjykate është se nuk janë përmbushur katër kushtet ligjore në mënyrë kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadiës për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i kësaj gjykate gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar, dhe se pretendimet tjera ankimore janë pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.991/2023, me datë 27.12.2023

Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi